



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



## SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagradi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vodosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Erik" Sh.P.K. të datës 26.03.2024 si dhe sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Guard De Capital" Sh.P.K., kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - Lot 1 dhe Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

### V E N D I M

- I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Erik" Sh.P.K. e datës 26.03.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - Lot 1 dhe Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1.
- II. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Guard De Capital" Sh.P.K. e datës 26.03.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - Lot 1 dhe Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1.
- III. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korrigjin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korrigjin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional si dhe aneksin 7 në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- IV. **NJOFTOHET** operatorët ekonomik "Erik" Sh.P.K. dhe "Guard De Capital" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- V. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Operatori ekonomik "Erik" Sh.P.K. me datë 26.03.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - Lot 1 dhe Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1. Ndërsa me datë 28.03.2024 edhe operatori ekonomik "Guard De Capital" Sh.P.K. ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës - Lot 1 dhe Lot 2" me nr. të prokurimit 616-24-1099-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesave për rishqyrtim të parashtruesve është gjetur se kërkesat janë të lejuara dhe janë parashtruar brenda afatit nga personat e autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesat. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesave.

Pretendimet e parashtruesit "Erik" Sh.P.K. janë si në vijim:

**Pretendimi nr. 1 – "Siq shihet Aneksi 7 Ak ka kerkuar një list te paisjeve duke percaktuar sasine e tyre per secilen LOTO. Kjo eshte shkelje te nenit 7 si dhe nenit 28 paragrafi 2 te LPP-se pasi një sasi e tille eshte e pamundur qe te plotesohet pasi po te merret vetem nga pika 5 deri me 8 eshte një kerkese enorme per një kontrate te tille. Edhe pas sqarimeve te kerkuara nga ana e jone se mos rastesisht edhe një gabim teknik ne njete e kerkuar ne nuk kemi marr per gjigje fare nga AK. Per me teper me dt.15.03.2024 AK duke ju referuar kërkesave te sqarimit te tenderit nga OE tjera te interesuara ne kete aktivitet ka sqaruar se kjo eshte kerkese e Njesise kerkuese dhe nuk mund te ndryshohet dhe eshte e nevojshme per shikak te specifikimeve te objekteve. Duke e ditur se nje kompani e cila eshte ne treg per sherbime te pastrimit per te marre pjese ne te 2 llotot duhet ti kete 140 trimera,60 kosite te barit,60 krama per pastrim te xhamave dhe 14 platforma po ashtu per pastrimine xhamave kjo eshte e pamundur qe te mos kete diskriminim dhe pamundesi pjesmarrje te te gjithe OE e interesuar ne kete aktivitet. Pika 7 dhe 8 te automjeteve te kerkuar janë per te njejtin qellim dhe duke e ditur kosoton e tyre ne treg kjo sasi eshte diskriminues dhe nuk lejon pjesmarrjen e OE duke e ul konkurencen".**

**Pretendimi nr. 2 – "Nje tjeter Argument eshte edhe 7.OE duhet me dorezim te ofertes ta paraqes analizen financiare me pagen bruto 400 euro per puntor sipas ATK-se dhe pushimet vjetore sipas Ligjit te Punes dhe materialin higjenik. Ta paraqes analizen financiare me pagen bruto 400 euro per puntor sipas ATK-se dhe pushimet vjetore sipas Ligjit te Punes dhe materialin higjenik. LOT 1 – Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – shkollat filllore OE duhet te deklarohet se do ti punesoj minimumi 77 puntore nga lista e Autoritetit Kontraktues, ndersa per kryerjen e ketyre sherbimeve duhet ti shkoj edhe 63 puntor nga personeli i tij gjithsej 140 punonjs e. LOT 2 përfshire aktivitetin - Pastrimin e objekteve edukativo arsimore të Komunës së Prishtinës – shkolat e mesme dhe çerdhet OE duhet te deklarohet se do ti punesoj minimumi 22 puntore nga lista e Autoritetit Kontraktues, ndersa per kryerjen e ketyre sherbimeve duhet ti shkoj edhe 29 puntor nga personeli i tij gjithsej 51 punonjs e.. Percaktimi i nr. te punetoreve se bashku me page te punetoreve e tejkalon vleren e parashikuar te kontrates dhe ne kekresen per sqarim nuk kemi marre per gjigje ne pytejn tone se si do te veprohet me oferta te cilat tejkalojne vleren e parashikuar dhe kjo perben shkelje te nenit 53".**

**Lidhur me pretendimin ankimore nr. 1** të parashtruesit "Erik" Sh.P.K., është konstatuar se duhet të rishiqohet mundësia e ndryshim/plotësimit të listës së pajisjeve të kërkuar përmes aneksit 7 ashtu që të mbeten vetëm ato pajisje që janë të domosdoshme për të zbatuar me sukses kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Nga ky këndvështrim duhet të korrigohet dosja e tenderit sa i përket sasive të kërkuar për këto pajisje (platformat ngritëse, etj). Duhet marrë parasysh që ky aktivitet i prokurimit është i ndarë në dy (2) lote, në dosjen e tenderit nuk është kufizuar e drejta që një operator ekonomik të ofertoj për të dy lotet mirëpo është kërkuar që për secilin lot veç e veç të dëshmohet lloji dhe sasia e pajisjeve të kërkuar përmes aneksit 7 në DT. Nga sa u tha më sipër dhe duke u bazuar në nenin 7 të LPP respektivisht parimin e mosdiskriminimit apo mosfavorizimit, duhet të korrigohet dosja e tenderit ashtu që të kërkohen vetëm pajisjet e domosdoshme për realizimin me sukses për të dy lotet e kontratës që synohet të lidhet me këtë aktivitet të prokurimit, duke përfshirë këtu edhe mundësinë që të shfrytëzohen pajisjet e njëjtë për të dy lotet pasi që bëhet fjalë për të njëtin aktivitet të prokurimit. Në këtë mënyrë do të stimulohet konkurenca ndërmjet operatorëve ekonomik ofertues në mbështetje edhe të nenit 7 të LPP. Kështu është gjetur se pretendimi ankimore nr. 1 është pjesërisht i bazuar.

**Lidhur me pretendimin ankimore nr. 2** të parashtruesit "Erik" Sh.P.K. përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Prandaj sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëj vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht njësia kërkuese ka ofruar sqarimin si në vijim "*Sqarimet: OE duhet të kete një menagjer me pervoje pune se paku 5 vite me pagë prej 500 euro te perfshitet ne analizen financiare dhe te deshmohet me trust dhe kontrata te punes. Vet fakti qe kerkohet trusti dhe kontrata e punes do të thotë se është kriter që duhet plotësuar nga OE qe menaxheri te kete 5 vite pervoje pune me pagë minimum 500 bruto euro. Sqarimet: OE duhet me dorezimin e ofertes te paraqes analizen financiare me pagën bruto 400 euro per punitor sipas ATK-se dhe pushimet vjetore sipas ligjit te Punes dhe materialin higjenik. Paga 400 euro me te gjitha taksat e ligjet e ATK kur te kalkulohen te gjitha vlera 400 euro për punitore*". Kështu është gjetur se pretendimin ankimore nr. 2 është i pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit "Guard De Capital" Sh.P.K. janë si në vijim:

**Pretendimi nr. 1** - "*Kritere janë vendosur kësaj here ku ato që bien në sy dhe janë të panevojshme janë: Kran per pastrimin e gjamave 30 m lartësi minimum 1, • Platform apo Paisje ngritese per pastrimin e gjamave me lartësi minimumi 32 m lartesi me gjersi deri në 1.30 m. Një listë te pasiжеve, sipas Aneksin 7 ku në Aneksin 7 janë kërkuar minimumi 7 Platform apo Paisje ngritese të cilat edhe në nivel vendi është e pamunudur të gjindet kjo sasi andaj kërkojn reduktimin e tyre dhe të lihen edhe opçione tjera si psh lift minutues etj".*

**Pretendimi nr. 2** - "*Lidhur me pagën AK ka cekur: Ta paraqes analizen financiare me pagën bruto 400 euro per punitor sipas ATK-se dhe pushimet vjetore sipas Ligjit te Punes dhe materialin higjenik. Vetë përcaktimi I pagës bruto nënkatpon shtimin e plus 5% të punëdhënësit mbi pagën bruto po ashtu respektimi I ligjit të punës dhe futja e materialit hixienikë në pagë është shumë absurditet!!! Në pytjen tonë të dërguar për sqarim kemi kërkuar që • Lidhur me pagën si e keni*

*menduar se a do të jetë 400 bruto ku pastaj duhet të shlohen 5% I punëdhënsit, plus pushimi vjetor plus TVSH apo pragu maximal me të gjitha të jetë 400? Dhe sa është niveli minimal I pagës NETO të punëtorit? Përgjigjëja ishte: Sqarimet: OE duhet me dorezimin e ofertes te paraqes analizen financiare me pagën bruto 400 euro per punitor sipas ATK-se dhe pushimet vjetore sipas ligjit te Punës dhe materialin ligjienik. Paga 400 euro me te gjitha taksat e ligjet e ATK kur te kalkulohen te gjitha vie te vlera 400 euro për punitor/e. Pra shihet qartë se AK nuk ka dhiënë përgjigjëje të mirë sqaruese dhe se nuk ka lënë siguri për vlerësim të drejtë përderi sa nuk përcakton nivelin minimal të pagës NETO? Kërkojm sqarimin dhe harmonizim konform LPP-së Këres tjetër tejet e paqartë është edhe OE duhet te kete një menagjer me pervoje pune se pak 5 vite me page prej 500 euro te perfshihet ne analizen financiare dhe te deshmohet me trust dhe kontrata te punës Në pytjen tonë ku kemi kërkuar që AK të na sqaroj Këtu e kemi shumë të pa qartë se a duhet ta ketë pasur pagën 500 euro (neto apo bruto) apo duhet ta kalkulojm pagën 500 euro dhe a është bruto a neto dhe pse nevojitet trusti? Përgjigjëja e AK-së është Sqarimet: OE duhet të kete një menagjer me pervoje pune se pak 5 vite me page prej 500 euro te perfshihet ne analizen financiare dhe te deshmohet me trust dhe kontrata te punës. Vet fakti qe kerkohet trusti dhe kontrata e punës do të thotë se është kriter që duhet plotësuar nga OE qe menaxheri te kete 5 vite pervoje pune me page minimum 500 bruto euro. Tani këtu mbetet shumë e pa qartë se a duhet Menagjeri ta ketë pasur pagën 500 euro për 5 vite gjëc cila është shumë diskriminues sepse ka menagjer edhe me 200 euro por e ka ushtruar atë profesion apo duhet tani e tijte tani t'i paguhet ajo page".*

**Lidhur me pretendimin ankimore nr. 1** të parashtruesit "Guard De Capital" Sh.P.K., është konstatuar se duhet të rishiqohet mundësia e ndryshim/plotësimi të listës së pajisjeve të kërkura përmes aneksit 7 ashtu që të mbeten vetëm ato pajisje që janë të domosdoshme për të zbatuar me sukses kontratën që synohet të lidhet përmes këtij aktiviteti të prokurimit. Nga ky këndvështrim duhet të korrigohet dosja e tenderit sa i përket sasive të kërkura për këto pajisje (platformat ngritëse, etj). Duhet marrë parasysh që ky aktivitet i prokurimit është i ndarë në dy (2) lote, në dosjen e tenderit nuk është kufizuar e drejta që një operator ekonomik të ofertoj për të dy lotet mirëpo është kërkuar që për secilin lot veç e veç të dëshmohet lloji dhe sasia e pajisjeve të kërkura përmes aneksit 7 në DT. Nga sa u tha më sipër dhe duke u bazuar në nenin 7 të LPP respektivisht parimin e mosdiskriminimit apo mosfavorizimit, duhet të korrigohet dosja e tenderit ashtu që të kërkohen vetëm pajisjet e domosdoshme për realizimin me sukses për të dy lotet e kontratës që synohet të lidhet me këtë aktivitet të prokurimit, duke përfshirë këtu edhe mundësinë që të shfrytëzohen pajisjet e njëjtë për të dy lotet pasi që bëhet fjalë për të njëjtin aktivitet të prokurimit. Në këtë mënyrë do të stimulohet konkurenca ndërmjet operatorëve ekonomik ofertues në mbështetje edhe të nenit 7 të LPP. Kështu është gjetur se pretendimi ankimore nr. 1 është pjesërisht i bazuar.

**Lidhur me pretendimin ankimore nr. 2** të parashtruesit "Guard De Capital" Sh.P.K. përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe paralogarinë. Prandaj sektori i prokurimit ka kërkuar nga njësia kërkuese që të bëj vlerësimin fillestar të pretendimeve ankimore. Rrjedhimisht njësia kërkuese ka ofruar sqarimin si në vijim "Sqarimet: OE duhet të kete një menagjer me pervoje pune se pak 5 vite me page prej 500 euro te perfshihet ne analizen financiare dhe te deshmohet me trust dhe kontrata te punës. Vet fakti qe kerkohet trusti dhe kontrata e punës.

*do të thotë se është kriter që duhet plotësuar nga OE qe menaxheri te kete 5 vite pervoj pune me page minimum 500 bruto euro. Sqarimet: OE duhet me dorezimin e ofertes te paraqes analizen financiare me pagen bruto 400 euro per puntor sipas ATK-se dñe pushimet vjetore sipas ligjit te Punes dhe materialin higjenik. Paga 400 euro me te gjitha taksat e ligjet e ATK kur te kalkulohen te gjitha vie te vlera 400 euro për puntor/e". Kështu është gjetur se pretendimin ankimore nr. 2 është i pabazuar.*

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtuesit kanë paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur vetëm pjesërisht pretendimet e tyre ankimore. Prandaj kërkesat për rishqyrtim janë miratuar si pjesërisht të bazuara.

Për pikën I, II dhe III të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën IV dhe pikën V të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënët më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 29.03.2024



#### Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.